



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 847/7 Prot.

Tiranë, më 27.12.2024

V E N D I M

Nr. 324, Datë 27.12.2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 118, datë 30.05.2024, e bërë nga z. Xh.N kundër Njesisë Administrative Cakran, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “*moshës*¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Unë i nënshkruari Z. Xh.N po ju dejtohem me këtë ankesë, pasi ndihem i diskriminuar për shkak të moshës, në një zvarritje të pa kuptimtë dhe pa bazë ligjore nga ana e Njesisë Administrative Cakran.

Konflikti im ka nisur me fqinjin tim, i cili ka qenë shqetësim për të gjithë banorët, bllokimi i rrugës nga ana e z. F.B në mënyrë të jashtëligjshme. (tani jeton e shoqja znj. B.B, dhe sot e kësaj dite ajo gjendet në banesë).

Kam bërë disa herë kërkesë/ankesë në Njesisë Administrative Cakran (ankesa e fundit nr. 186, datë 12.02.2024 drejtuar njësisë) dhe rruga është hapur dy herë para disa vitesh (2017) e cila është bllokuar sërish nga fqinjët e konfliktit, por tani nga ana e Njesisë Administrative nuk po veprohet më. Ankesa/kërkesa e fundit është bërë më datë 27.03.2024, drejtuar Bashkisë Fier që të marrë masa për zgjidhjen e konfliktit.

¹ Referuar kartës së identitetit, z. Xh.N ka lindur në datë 11.02.1943.

Gjatë kohës kur ka qenë administrator z. T.Xh, janë ngritur shumë urdhëra pune e janë marrë masa të hiqet porta e cila bllokoi rrugën, por më vonë është zënë sërish nga familja B. Që nga viti 2022, administratori i Njësisë Cakran është z. F.K.

Pas ankesës së drejtuar Bashkisë Fier me datë 27.03.2024, Bashkia ka dhënë urdhër verbalisht që të hapet rruga dhe nga Drejtoria e Policisë Fier kanë ardhur për të zbatuar vendimin e liritimit të rrugës por deri më sot unë nuk po shikoj rrugëzgjdhje dhe kjo më duket një burokraci e jashtëligjshme të cilës nuk po i gjej përgjigje. Nga ana e administratorit shikoj vetëm zvarritje dhe përcjellje, asnjë veprim apo interesim konkret”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për hapjen e rrugës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a publikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, apo në raport me të drejtat e tyre ligjore.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 847/1, datë 05.06.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga palët, për ankesën e bërë, si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Kopje të ankesave të bëra nga z. Xh.N, pas datës 01.05.2022, lidhur me këtë çështje dhe përgjigjet e dhëna nga Bashkia Fier dhe Njësia Administrative Cakran.
 - Informacion dhe kopje të plotë të dokumentacionit lidhur me procedurën e ndjekur dhe veprimet e kryera nga Bashkia Fier dhe Njësia Administrative Cakran, për zgjidhjen e ankesave/kërkesave të bëra nga z. Xh.N, për çështjen objekt shqyrtimi, pas datës 01.05.2022.
 - Kopje të praktikave të qytetarëve të tjerë, të cilët kanë pasur problematikë të njëjtë apo të ngjashme me ankuesin. Cila është procedura e ndjekur? Si është vepruar me ta?

Me shkresën nr. 990/2, datë 15.06.2024, Njësia Administrative Cakran, informoi Komisionerin se: “Z. Xh.N është paraqitur për të bërë ankesë në Njësia Administrative Cakran në datë 12.02.2024, protokolluar po atë ditë me nr. 186, me objekt hapjen e rrugës këmbësore për tek varrezat në vendin e quajtur “Gropa e Mollës”, sipas pretenduesit e bllokuar nga familja e z. F.B, banorë të fshatit Hambar.

Nga ana e Njesisë Administrative Cakran është marrë koha e duhur për verifikimin e dokumentacionit të pronësisë ku kalon rruga, përkatësisht në pasurinë me nr. 311/1, e cila sipas azhurnimit ka marrë numrin e pasurisë 311/15, me kufizime Veri pasuria me nr. 320, Lindje me pasurinë me nr. 323, Jug me pasurinë me nr. 314/4, Perëndim me pasurinë me nr. 314/13. Me pronarë trashëgimtarët e znj. F.S dhe me zë kadastral Kullotë, e kthyer nga Komisioni i Kthimit të Pronave, e cila kufizohet me familjen e z. F.B. Kjo rrugë i shërben vetëm

familjes së z. F.B dhe trashëgimtarëve të znj. F.S, si dhe porta e vendosur nga familja e z. F.B është në kufirin e këtyre pronave (bashkëlidhur dokumentacioni).

Ankesa e z. Xh.N nuk qëndron dhe nuk ka asnjë lloj diskriminimi pasi zotëria nuk ka asnjë lidhje me pronat në fjalë. Përsa i përket rrugës për tek varrezat e “Gropës së Mollës”, rruga ekziston dhe është e hapur plotësisht edhe për automjete në një segment tjetër (bashkëlidhur hartat e printuara nga ASIG).

Pranë Njesisë Administrative Cakran me datë 03.04.2024, ka ardhur ankesa e bërë nga qytetari në Bashkinë Fier me nr. 186/1, datë 03.04.2024. Për verifikimin paraprakisht të situatës, ka shkuar grupi i punës i përbërë nga topografi S.B, agronomi V.B dhe punonjësi i shërbimeve B.M, me mbështetjen e Inspektorit të Policisë Bashkiake Fier, A.D dhe G.L.

Përsa i përket pretendimit të z. Xh.N se ka bërë disa herë ankesa për të njëjtin problem, gjatë periudhës 01.03.2022 deri më sot ku Administrator i Njesisë Cakran është z. F.K rezulton të jenë bërë dy ankesa. Ankesa me nr. 903, datë 27.05.2022, me objekt “Konflikt me E.B” për ujërat në rrugë, si dhe ankesa me nr. 186, datë 12.02.2024. Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nga ana e Njesisë Administrative Cakran nuk ka pasur asnjë lloj diskriminimi apo zvarritje e mosinteresim konkret, por sipas mundësive të lëvizjes në territor, pasi Njësia nuk disponon mjete transporti, por sipas situatave u kemi shërbyer. Pas hulumtimit të dokumentacionit të pronësisë është bërë sqarimi i kësaj shtate dhe i është komunikuar verbalisht qytetarit, nga topografi i Njesisë. Dosja me dokumentet e pronësisë të kthyer nga Komisioni i Kthimit të Pronave ndodhet në Drejtorinë e Pyjeve, Bashkia Fier, së bashku me procesverbalet e dorëzimit të pronave.

Njësia Administrative Cakran është e predispozuar dhe e gatshme të ndihmojë dhe zgjidhë problematikat e qytetarëve në kohë dhe pa zvarritje, brenda tagrit që i lejon ligji”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi nëpërmjet specialistes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Zyra Fier, është njohur me përgjigjen e Njesisë Administrative Cakran.

Subjekti ankues me shkresën datë 20.06.2024, ka deklaruar se: “Kam zbuluar dhe shkakun e nepotizmit, ku kryetari i Njesisë Administrative Cakran, z. F.K ka lidhje miqësore me z. A.T në Sheq Musalalaj. Lidhja qëndron se z. A.T lidh në miqësi z. K me komshiun që është krijuar konflikti, kanë dhënë motrat duke lidhur martesë me fëmijët e A.T”.

Në përgjigje të shkresës së Njesisë Administrative Cakran, subjekti ankues në datë 02.07.2024, ka bërë deklarimin, si më poshtë: “Nuk jam aspak dakord me pretendimet e parashtruara nga Njësia Administrative Cakran. Z. B nuk ka pronë, gjë që është e vërtetuar dhe kur më ka ngritur padi. Rruga ku z. B ka vendosur portën, është pronë e familjes S, i cili nuk më ka hapur probleme. Citoj se Njësia Administrative Cakran për kërkesë/ankesën e bërë në datë 12.02.2024, më ka kthyer përgjigje në datë 22.06.2024. Në rast se porta është e vendosur në pronën e z. B me dokumente unë heq dorë nga ankesa”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 847/3, datë 21.08.2024 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 29.08.2024, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi kopje të dokumentacionit, si më poshtë:
 - Kopje të plotë të dokumentacionit lidhur me procedurën e ndjekur dhe veprimet e kryera nga Njësia Administrative Cakran, për verifikimin dhe zgjidhjen e ankesës së bërë nga z. Xh.N, protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 186/1, datë 03.04.2024 (urdhër për ngritjen e grupit të punës, veprimet e Njesisë Administrative Cakran, për ndjekjen e Procesverbalit të konstatimit nr. 186/2, datë 20.05.2024).

Seanca u zhvillua në datë 29.08.2024, vetëm me praninë e përfaqësuesit² të Njesisë Administrative Cakran, z. S.B me detyrë topograf dhe në mungesë të subjektit ankues, i cili njoftoi se e kishte të pamundur pjesëmarrjen në seancë.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Njesisë Administrative Cakran i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, si dhe deklaroi se: *“Z. Xh.N është shprehur vetë që porta është e vendosur tek prona e familjes S. Pra z. Xh.N duhet ta zgjidhë çështjen me trashëgimtarët e familjes S, pasi ajo është pronë e kthyer nga Komisioni i Kthimit të Pronave. Një nga trashëgimtarët e familjes S ka ardhur para tre vitesh tek njësia dhe ka treguar dokumentet e pronës. Kur është ankuar z. Xh.N, kemi ngritur grupin e punës, mblodhëm dokumentacionin dhe dokumentet thonë që ajo është tokë e kthyer ish pronarit. Aty ka pasur një rrugë kalimi për këmbësorë, pasi e kanë lënë ish pronarët e tokës. Ajo rrugë kalimi për këmbësorë i shërbente vetëm trashëgimtarëve të familjes B dhe familjes S. Banesa e z. Xh.N është rreth 500 metra larg dhe nuk e pengon kalimin për në shtëpinë dhe pronën e tij. Për të shkuar tek varrezat e vjetra të fshatit, lëvizet nëpërmjet rrugës automobilistike. Z. F.B nuk jeton më dhe aty jeton bashkëshortja e tij, znj. B.B, rreth 70 vjeç. Porta është vendosur me mirëkuptimin e dy familjeve, S dhe B”*.

Me shkresën nr. 990/7, datë 06.09.2024, Njësia Administrative Cakran dërgoi dokumentacionin e kërkuar gjatë seancës dëgjimore.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

² Referuar Autorizimit nr. 990/6, datë 28.08.2024, të Njesisë Administrative Cakran.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.*

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b³, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfutur të mira apo shërbime dhe më konkretisht në lidhje me mosmarrjen e masave nga ana e Njësisë Administrative Cakran.

Bazuar në deklaratimet e provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe kronologjisë së ngjarjeve, rezultoi se:

Z. Xh.N me ankesat nr. 186, datë 12.02.2024 dhe nr. 186/1, datë 03.04.2024, drejtuar Njësisë Administrative Cakran dhe Bashkisë Fier, ka kërkuar zhbllokimin e rrugës së varrezave të bllokuar nga z. F.B.

Referuar Procesverbalit nr. 186/2, datë 20.05.2024, të mbajtur nga grupi i punës i ngritur nga Njësia Administrative Cakran për verifikimin e rastit, rezulton se grupi i punës ka konstatuar se familja e z. F.B kishte vendosur një portë hekuri me rrjetë teli në kufirin e pronës së tij dhe kullotës (pronë e familjes S).

³ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: "*Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...*";

Në përgjigje të ankesës së z. Xh.N, Njësia Administrative Cakran, me shkresën nr. 186/3, datë 27.06.2024, në mes të tjerash ka informuar ankuesin se: *“Nga verifikimi i dokumentacionit për pasuritë ku kalon rruga, rezulton se pasuria kullotë që ju pretendoni si pronë shtetërore, është pronë private e kthyer nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, trashëgimtarëve të znj. F.S dhe ky dokumentacion ndodhet pranë Drejtorisë Pyjore të Bashkisë Fier. Rruga në fjalë u shërben vetëm dy familjeve, familjes së z. F.B e cila banon aty dhe trashëgimtarëve të znj. F.S. Nëse ju si person dispononi dokumentacion pronësie për problemin në fjalë, ju lutemi ti paraqisni pranë Njesisë Administrative Cakran, në të kundërt nëse nuk keni dokumentacion i cili të tregojë lidhjen tuaj me pronën në fjalë, por mendoni se u takon rrugëkalimi, ju lutem ti drejtoheni Gjykatës për “Servituti i Kalimit”, sipas Kodit Civil, nenet 277, 278 dhe 179”.*

Ligji nr. 139, datë 17.12.20215 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar, në nenin 66, të tij, ka parashikuar se: *“Administrata e njësisë administrative kryen këto detyra:*

- a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;
- b) mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;
- c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;
- ç) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;
- d) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë tregjet publike;
- dh) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;
- e) përgatit dhe i propozon kryetarit të bashkisë planin për investimet nën juridiksionin e saj territorial, si dhe mbikëqyr, pas miratimit, zbatimin e tyre, sipas ligjit;
- ë) propozon, sipas ligjit, emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj territorial;
- f) mbështet, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryetarëve e të kryesive të fshatrave;
- g) i propozon kryetarit të bashkisë dhënie të titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial;
- gj) propozon marrjen e nismave në dobi të komunitetit me mundësi të barabarta dhe përfitime nga të gjithë brenda juridiksionit të saj territorial;
- h) kryen çdo funksion tjetër të deleguar nga kryetari i bashkisë”.

Nga këqyrja e dokumentacionit të depozituar, analizimi i provave, parashtrimeve të Njesisë Administrative Cakran, si dhe të legjislacionit në fuqi, Komisioneri konstaton se nga ana e Njesisë Administrative Cakran, është vepruar konform kompetencave e përgjegjësive të saj, në përmbushje të përcaktimeve ligjore, lidhur me trajtimin e rastit, sipas dokumentacionit që dispononte njësia administrative dhe palët.

Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se, me Vendimit nr. 13, datë 26.09.2002, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, ka vendosur: *“1. Ti njohë pronën ish-*

pronarit B.V mbi një sipërfaqe toke pyll prej 13 ha dhe 4.4 ha tokë kullotë në fshatin Hambar, Komuna Cakran. 2. Në mbështetje të nenit 7/1, të ligjit 7699, datë 21.04.1993, ish-pronarit (trashëgimtarit F.S) ti kthejë sipërfaqen prej 13 ha tokë pyll dhe 4.4 ha tokë kullotë në fshatin Hambar, Komuna Cakran me nr. parcele 12b, 13b, dhe 4 sipas gjendjes kadastrale të kadastrës së pyjores me kufizimet e lartpërmendura.”.

Referuar Vërtetimit nga dokumentit hipotekor nr. 272, datë 15.05.2003 dhe Kartelës treguese të rregjistrimit të pasurisë, vërtetohet që nr. i pasurisë 311/1, me adresë: Rrethi Fier, Fshati Hambar, rezulton në pronësi të znj. F.S.

Nga ana e z. Xh.N nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit ndonjë dokumentacion pronësie në lidhje me pronën objekt shqyrtimi.

Referuar deklarimit të Njësisë Administrative Cakran, gjatë seancës dëgjimore, rezulton se porta është vendosur nga z. F.B me mirëkuptimin e familjes S, në pronën e familjes S dhe rrugë kalimi i shërben vetëm këtyre dy familjeve.

Në përfundim të gjithë sa më sipër, Komisioneri konstaton se, nga ana e Njësisë Administrative Cakran janë ndërmarrë hapat e duhur për shqyrtimin e rastit dhe informimin e z. Xh.N.

Për rrjedhojë, në këtë kontekst, Komisioneri konstaton se, nuk ka patur veprime apo mosveprime të Njësisë Administrative Cakran, që të ketë vënë në pozita të pafavorshme z. Xh.N.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm të ankueses, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm të ankuesit, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun” e pretenduar.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Njësisë Administrative Cakran.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. Xh.N, për shkak të moshës, nga ana e Njesisë Administrative Cakran.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA